

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTAVE

Sot, më 17.01.2022 (“**Data e Nënshkrimit**”) në Tiranë, Palët e mëposhtme, kanë lidhur dhe kanë ekzekutuar këtë kontratë për shitjen e kuotave (“**Kontrata**”):

- **Z. Ildir Ylli Themeli**, shtetas shqiptar, lindur më 13.07.1984, në Tirane, mbajtës i leternjoftimit me nr. personal I40713103J, rezident në Tirane, (në vijim si “**Shitësi**”); dhe
- **Znj. Eneida Abdulla Bica**, shtetase shqiptare, e lindur më 12.07.1989, në Tirane, mbajtëse e leternjoftimit me nr. personal I95712074F, rezidente në Tirane (në vijim si “**Blerësi**”).

DUKE QENË SE

- A. Shitësi është ortak i vetëm i shoqërisë FACT Shpk., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008, pranë Regjistrat Tregtar të Shqipërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”), me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L82008005L, me seli të regjistruar në adresën: Blv. “Deshmoret e Kombit”, Kullat Binjake, Qendra Tregtare, Kati 2, Nr. 24, Tiranë, Shqipëri (në vijim si “**Shoqëria**”).
- B. Kapitali i nënshkruar dhe plotësisht i shlyer i Shoqërisë është 10,000.00 (dhjetë mijë) lekë.
- C. Shitësi është pronari i ligjshëm dhe titullari i 1 (një) kuote (pjesë), që i korrespondon 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë, në vlerën e 10,000 (dhjetë mijë) lekë (“**Kuota**” ose “**Kuota në Shitje**”).
- D. Shitësi dëshiron të shesë dhe Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi Kuotën në Shitje, që Shitësi zotëron në kapitalin e shoqërisë dhe që përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë.
- E. Palët kanë marrë të gjithë vendimet e duhura për ekzekutimin e transaksionit siç përcaktohet në këtë Kontratë.

Palet e sipërper mendura me vullnetin e tyre të lire e të plote rane dakord për sa më poshtë:

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Nepermjet kësaj Kontrate, Shitësi i shet Blerësit Kuotën që Shitësi zotëron në kapitalin e Shoqërisë dhe që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, dhe Blerësi blen nga Shitësi Kuotën në Shitje kundrejt Çmimit të Blerjes (sikurse është për kufizuar më poshtë) (“**Shitja e Kuotave**” ose “**Transaksioni**”).

NENI 2

ÇMIMI I BLERJES DHE MËNYRA E PAGESËS

2.1. Çmimi për blerjen dhe transferimin e Kuotës nga Shitësi tek Blerësi është **10,000 Leke (dhjetë mijë leke)** (“**Çmimi i Blerjes**”).

2.2 Cmimi i Blerjes paguhet rregullisht nga Bleresi te Shitesi ne momentin e nenshkrimt te kesaj kontrate.

NENI 3 BERJA EFEKTIVE E KONTRATES DHE REGJISTRIMI

3.1. Kjo Kontrate do te behet efektive menjehere ne ditën e nenshkrimt te saj nga Palet.

3.2. Kjo Kontrate do te depozitohet dhe regjistrohet prane QKB dhe regjistrimi i Bleresit si pronar ligjor i Kuotave ne Shitje do te behet menjehere me firmosjen e saj nga Palet.


NENI 4 DISPOZITA PERFUNDIMTARE

4.1. Kjo Kontrate eshte hartuar ne 2 (dy) kopje ne gjuhen shqipe, secila me vlere te njejte ligjore.

4.2. Palet deklarojne se jane dakord me permbajtjen e kesaj Kontrate dhe se e nenshkruajne ate me vullnetin e tyre te lire.

BLERËSI

Eneida Bica

Eneida Bica


SHITËSI

Idlir Themeli

Idlir Themeli
